



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL

VENDIM NR 126 Datë 02.10.2020

“Për dhënie në përdorim nga fondi pyjor”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 , “Për vetëqeverisjen vendore” dhe në zbatim të VKM - s Nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipa listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” Shtojca 6, me propozim të Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Dibër, bazuar në kërkesën e z. Luris Abazi banues në Njësinë Administrative Sllovë për dhënien në përdorim nga fondi pyjor publik të sipërfaqes që do të përdoret për ndërtimin e Bujtinës me shkresën datë 11.06.2020, protokolluar pranë bashkisë sonë me Nr.1998 prot. datë 11.06.2020, Këshilli Bashkiak vendosi me datë 02.10.2020 me 20 vota pro 0 vota kundër 0 vota apstenim.

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien në përdorim me qira të sipërfaqes pyjore prej **0.4620 ha** (zero pikë katër mijë e gjashtëqind e njëzetë ha) ose **4 620 m²** (katër mijë e gjashtëqind e njëzetë m²), ngastra nr.82/a të ekonomisë pyjore Kastriot Sllovë për ndërtimin e Bujtinës .
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Pyjeve dhe Kullotave në Bashki.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Dibër.

Kryetar Këshilli

Sokol SAVA

